

VENDIM
Nr. 650, datë 10.11.2017

PËR ANGAZHIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR RUAJTJEN E BESIMIT NË STATISTIKA¹

Në mbështetje të pikës 1, të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Angazhimin e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për ruajtjen e besimit në statistika, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**ANGAZHIMI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
PËR RUAJTJEN E BESIMIT
NË STATISTIKA**

1. Duke marrë parasysh se:

a) statistikave të besueshme janë një element kryesor për proceset informuese, politikëbërëse dhe vendimmarrëse për Këshillin e Ministrave, qytetarët, subjektet private dhe publike;

b) besueshmëria në statistikave zyrtare është parakusht për të rritur dhe garantuar suksesin ekonomik dhe social të vendit;

c) besimi i publikut në statistika kushtëzohet në thelb nga zbatimi i plotë i parimeve të Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane, të cilat janë përfunduar plotësisht në ligjin nr. 9180, datë 5.2.2004, “Për statistikave zyrtare”, të ndryshuar dhe, në veçanti, për ruajtjen e pavarësisë profesionale të autoriteteve kombëtare të ngarkuara me ligj për prodhimin e statistikave zyrtare;

ç) cilësia e përgjithshme e statistikave mbështetet, gjithashtu, në cilësinë e burimeve primare të të dhënave;

d) angazhimi për ruajtjen e besimit në statistika rrjedh si objektiv i shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, për zbatimin e nenit 11, pikat 3, 4 dhe 5 të Rregullores (KE), nr. 223/2009, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 11 mars 2009, “Mbi statistikave evropiane”, e cila shfuqizon Rregulloren (KE, Euroatom), nr. 1101/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit mbi dërgimin e të dhënave, të cilat i nënshtrohen konfidencialitetit statistikor, Zyrës Statistikore të Komuniteteve Evropiane, Rregulloren e Këshillit (KE), nr. 322/97 “Mbi Statistikat e Komunitetit dhe vendimin e Këshillit 89/382/EEC, Euroatom për krijimin e një komisioni mbi programet statistikore të Komuniteteve Evropiane”, ndryshuar

¹ Ky vendim është përfunduar pjesërisht me:

1. Rregulloren (KE) nr. 223/2009, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 11 mars 2009, “Mbi statistikave evropiane”, e cila shfuqizon Rregulloren (KE, Euroatom), nr. 1101/2008, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, mbi dërgimin e të dhënave, të cilat i nënshtrohen konfidencialitetit statistikor, Zyrës Statistikore të Komuniteteve Evropiane, Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 322/97, “Mbi statistikave të komunitetit” dhe vendimin e Këshillit 89/382/EEC, Euroatom për krijimin e një komisioni mbi programet statistikore të Komuniteteve Evropiane”. Numri CELEX: 32009R0223, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, nr. 87, datë 31.3.2009, faqe 164–173.

2. Rregulloren (KE) nr. 2015/759 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 29 prill 2015, e cila ndryshon Rregulloren (KE) nr. 223/2009, për statistikave evropiane. Numri CELEX: 3A32015R0759, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, datë 19.5.2015, faqe 123/90–123/97.

me Rregulloren (KE) të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 29 prill 2015.

2. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë rikonfirmon angazhimin e tij të plotë, për sa vijon:

a) Të respektojë, plotësisht, standardet ndërkombëtare dhe evropiane për cilësinë e statistikave zyrtare, në veçanti parimet e Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane;

b) Të garantojë dhe të mbrojë pavarësinë profesionale të Institutit të Statistikave (INSTAT), dhe ta promovojë atë në publik nëpërmjet veprimeve të duhura komunikuese;

c) Të mbështesë Institutin e Statistikave në ruajtjen e besimit të publikut në statistikat zyrtare që prodhohen në Republikën e Shqipërisë dhe të mbrojë stafin e angazhuar në prodhimin statistikor nga çdo përpjekje për të prishur besueshmërinë e tij;

ç) Të sigurojë burimet e përshtatshme dhe të qëndrueshme, të nevojshme për të kryer aktivitetet statistikore dhe për të ruajtur e përmirësuar më tej cilësinë e statistikave zyrtare të Republikës së Shqipërisë;

d) Të raportojë çdo vit në Komisionin Evropian për zbatimin e këtij angazhimi;

dh) Të rishikojë angazhimin e Këshillit të Ministrave për ruajtjen e besimit në statistika, në rast të nevojës për përmirësimin e tij, të identifikuar nga Këshilli i Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ose Komisioni Evropian.